

Takimin II i Grupit të Punës së EUROSAT-t mbi Përfitimet dhe Metodologjitë e Auditimit në Kohë Reale Budapest, 4-5 qershor 2024

Në Budapest, më datat 4-5 qershor 2024, u organizua takimi II nga Grupi i Punës së EUROSAT-t mbi Përfitimet dhe Metodologjitë e Auditimit në Kohë Reale ku KLSH është anëtare.

Ky aktivitet u organizua nga SAI i Hungarisë dhe u udhëhoq nga SAI i Italisë (i cili njëkohësisht udhëheq Grupin e Punës), me pjesëmarrje të shumë SAI-ve të tjera.

Auditimi në Kohë Reale zhvillohet në kohë dhe mënyra të ndryshme në Institucione Supreme Auditimi të ndryshme; ndërsa vijon të ketë SAI-e, të cilat ende nuk kryejnë auditime në kohë reale. Nevoja për Auditime në Kohë Reale, doli në pah veçanërisht si pasojë e pandemisë, e cila diktoi urgjencën për pajisjen e SAI-ve me mjete për përballimin e situatave emergjente. Sa më sipër, përshpejtoi nevojën që SAI-et të vlerësonin ndër të tjera edhe përdorimin e Auditimit në Kohë Reale si një ndër këto mjete. Dobia e këtij lloj auditimit pasoi me nevojën për të ndarë dhe shkëmbyer përvojat dhe praktikat e mira në këtë drejtim. Në këtë vazhdë ishte edhe organizimi i këtij takimi, ku SAI si ai i Qipros, Francës, Hungarisë, Italisë, Portugalisë dhe Anglisë, paraqitën metodologjitë dhe ndanë përvojat e tyre mes homologëve.

Prezantimet sollën shembuj konkret si në rastin e SAI-t të Portugalisë mbi auditimin në kohë reale të Ditës Botërore të Rinisë, 2023, ku Lisbona u shpall vendi mikpritës dhe si pasojë për realizimin e këtij aktiviteti u përfshi përdorimi i fondeve publike, subjekt auditimi. SAI i Anglisë gjithashtu, paraqiti metodologjitë e përdorura nëpërmjet ilustrimit me një auditim konkret mbi skemën e financimit të kostove të banimit për popullin e Ukrainës që u larguan prej luftës. Ngjalli interes dhe diskutime fakti që, për këto lloj auditimesh, SAI i Anglisë nuk konkludon as me konkluzione, as me rekomandime duke paraqitur vetëm gjetjet/dukurinë dhe duke ia lënë vetë subjekteve të audituara marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

SAI i Qipros gjithashtu prezantoi në mënyrë shumë të detajuar metodologjinë e përdorur për Auditimet në Kohë Reale, nëpërmjet informatizimit të procesit dhe përdorimit të databazave të dizenuara për të ndjekur këtë proces.



Në përfundim të këtij takimi, u theksua edhe njëherë rëndësia e Auditimit në Kohë Reale që lidhet me një veçori që i bën ato të dobishme dhe që është qëllimi i tyre për të identifikuar fushat më të rëndësishme dhe mundësitë/shancet/risqet për të ndodhur keqmenaxhimi. Në këtë kuptim, një Auditim në Kohë Reale mund të shërbejë gjithashtu si një mbështetje por edhe si një hap i parë për auditimet tradicionale të performancës.

Takimi i radhës i Grupit të Punës të EUROSAI për “Përfitimet dhe Metodologjitë e Auditimit në kohë reale” do të zhvillohet në Bukuresht.

Kontrulli i Lartë i Shtetit, në këtë aktivitet, u përfaqësua nga znj. Valbona Gaxha, Sekretare e Përgjithshme dhe znj. Aulona Jonuzi, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.